



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 22 të Ligjit nr.03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme , nenit 4 të Udhëzimit administrativ nr.05/2011 për ankesat për tatimin në pronën e paluajtshme si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR THEMELIMIN E BORDIT KOMUNAL PËR ANKESA

Neni 1
Përbërja

Themelohet Bordi Komunal për shqyrtimin e ankesave për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2018, në këtë përbërje:

- 1.Shaban Syla, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Kryesues
- 2.Illir Shala, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër anëtar
- 3.Bajram Sinani, Drejtorati për Planifikim,Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar
- 4.Shqipe Rexhepi, Drejtorati për Inspektorat anëtare
- 5.Lidija Jovanoviq, Zyra Lokale për Komunitete, anëtare

Neni 2

Detyrat , përgjegjësitë dhe takimet e Bordit Komunal për Ankesa

Bordi Komunal për ankesa do ti kryej detyrat në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe të dispozitave të nenit 5, 6, 7 dhe 8 të Udhëzimit administrativ nr.05/2011 për ankesat për tatimin në pronën e paluajtshme.

Vendi i mbajtjes të mbledhjeve të Bordit Komunal të ankesave, do të jetë në hapësirën brenda Ndërtesës të Organeve të Administratës , por jo në zyrën e Tatimit në Pronë dhe zyrën e financave.

Neni 3

Vendimet e Bordit

Vendimet e marra nga Bordi i Ankesave, Sektori i Tatimit në Pronë konform nenit 7 par.2 të Udhëzimit Administrativ ua dërgon parashtruesve të ankesave në afat prej 10 ditëve nga dita e miratimit të Vendimit. Sektori i Tatimit në Pronë është i obliguar që ti ndihmoj Bordit në ofrimin e të dhënave për zgjidhjen e ankesave konform nenit 5 par.1.4 dhe 1.5 të Udhëzimit administrativ.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Bordit Komunal për Ankesa si dhe Sektori për tatim në pronë .

1Nr. 432-6848
Lipjan, më 02.02.2018

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

Imri Ahmeti

